



**Shtyhet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së,
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+,
në Riga Technical University, Letoni**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është shtyrë thirrja për aplikime për bursa për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Riga Technical University – RTU.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor për studime.
- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe të kenë përfunduar vitin e parë akademik).
- **Master** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin Politeknik të Tiranës).

Kohëzgjatja e bursave për studentët: 1 semestër, (semestri i dytë, i vitit akademik 2023-2024)

Fushat e studimit për studentët: Të gjitha degët. (Studentë e interesuar të shohin lëndët që ofrohen nga RTU, sipas fakulteteve përkatëse, në linkun: [Faculties | Riga Technical University \(rtu.lv\)](https://www.rtu.lv/faculties))

Numri total i studentëve: 4 studentë

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*



**Key Action 1
– Mobility for learners and staff –**

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në RTU lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshatën në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga Koordinator Akademi i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement” klikoni te:

[Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](https://upt.edu.al) , aneks 2.

Për t’u njohur me lëndët që ofrohen në RTU, sipas niveleve dhe fushave të studimit, klikoni në link-un: [Faculties | Riga Technical University \(rtu.lv\)](https://rtu.lv)

Afati për aplikim për studentët: Deri më 16 tetor 2023, ora 10.00

Aplikimi për studentët kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail: abeqo@upt.al , rkodra@upt.al